

1 E enjte, 23 shtator 2021

2 [Konferencë e Ecurisë së Çështjes]

3 [Seancë e hapur]

4 --- Seanca fillon në orën 09.00.

5 [I akuzuari u paraqit përmes videolidhjes]

6 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Mirëdita të gjithëve dhe  
7 mirë se erdhët brenda dhe jashtë sallës së gjyqit.

8 Znj. Sekretare mund të paraqitni lëndën ju lutem.

9 SEKRETARJA E GJYKATËS: Mirëdita i nderuar Gjykatës, kjo  
10 është lënda KSC-BC-2020-04, Prokurori i Specializuar kundër  
11 Pjetër Shalës.

12 GJYKATËSI GUILLOU: Faleminderit znj. Sekretare. U lutem  
13 palëve dhe pjesëmarrësve që të prezantohen duke filluar nga  
14 Zyra e Prokurorit të Specializuar.

15 Z. Prokuror e keni fjalën.

16 Z. O'DOWD: Faleminderit i Nderuar Gjykatës. Mirëdita juve  
17 dhe mirëdita të gjithëve. Sot për Prokurorinë është nëpunësi  
18 juridik Bernhard Kuschnik; Menaxherja e lëndës Angel Langenberg  
19 dhe Daniel Mezei. Unë jam Prokurorit Sean O'Dowd.

20 Kjo është seanca e fundit për znj. Langenberg, e cila do  
21 të kalojë në një punë tjetër. E falënderojmë për punën e saj  
22 dhe informoj Gjykatën se z. Mezei do të marrë përsipër detyrën  
23 e saj për këtë çështje gjyqësore.

24 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Prokuror. I  
25 uroj më të mirat në sfidat e ardhshme. Tani i kalojmë fjalën

1 Mbrojtjes, z. Gilissen.

2 Mikrofonin ju lutem.

3 Z. GILISSEN: [Përkthim] Po, tani është më mirë.

4 Faleminderit. Kam për krenari që të prezantoj z. Aouini,  
5 bashkë-avokatin dhe një person të ri në ekip, një stazhiere  
6 znj. Manon Mollaret. Është frëngjisht-folëse nga Marseja, e  
7 cila mund ta kuptojë dhe më mirë se çfarë dua të them unë. Kemi  
8 dhe z. Shala bashkë me ne përmes videolidhjes dhe kështu jemi  
9 të plotësuar.

10 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit shumë z.

11 Gilissen.

12 Z. Roche, Zyra Administrative.

13 Z. ROCHE: [Përkthim] Mirëdita i Nderuar Gjykatës, jam

14 Ralph Roche nga Zyra Administrative.

15 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Vërej se z. Shala ka hequr

16 dorë nga e drejta për të qenë i pranishëm në sallë dhe se e

17 përcjell këtë konferencë për ecurinë e çështjes përmes

18 videolidhjes.

19 Për procesverbalin, më quajnë Nicolas Guillou, Gjykatës i

20 Procedurës Paraprake për këtë çështje gjyqësore.

21 Më 14 shtator, kam caktuar datën për Konferencën e Tretë

22 për Ecurinë e Çështjes për këtë çështje gjyqësore. Sot kam për

23 qëllim që të shqyrtojmë ecurinë e çështjes dhe të organizojmë

24 shkëmbimet midis palëve për të siguruar një përgatitje të

25 përshpejtuar për gjykim.

1 Në veçanti dëshiroj që të diskutoj sa më poshtë: nxjerrjen  
2 e materialit provues, përkthimet, ecurinë e hetimeve të  
3 Prokurorit të Specializuar dhe datën e dosjes paraprake të ZPS-  
4 së, ecurinë e hetimeve të Mbrojtjes, pikat juridike dhe faktike  
5 për të cilat palët pajtohen, regjimi i paraburgimit, dhe në  
6 fund çdo çështje që palët mund të dëshirojnë që të ngrenë.

7 Falënderoj ZPS-në dhe Mbrojtjen për parashtrimet e tyre  
8 parapraakisht për këtë konferencë për ecurinë e çështjes. Si  
9 zakonisht, u kërkoj palëve që të flasin në mënyrë koncize për  
10 çdo pikë të rendit të ditës, të cilat do t'i marr një për një.

11 Dëshiroj të filloj me temën e parë që kemi në rendin e  
12 ditës sot që është nxjerrja. Do t'ua jap fjalën palëve për  
13 nxjerrjen e çdo kategorie, materiali provues veçmas, duke  
14 filluar nga materiali provues, më falni nga materiali i  
15 Rregullës 102(1)(b), që janë materialet provuese që Prokurori i  
16 Specializuar synon të paraqitet në gjykim; pas së cilës do të  
17 flasim për materialin e Rregullës 102(3), që është material i  
18 rëndësishëm për çështjen siç është përcaktuar nga ZPS-ja;  
19 pastaj materiali i Rregullës 102(3), që është materiali  
20 shfajësues; dhe në fund do flasim për materialin e Rregullës  
21 107, që është materiali i mbrojtur, për të cilin kërkohet  
22 pëlqimi i dhënësit.

23 Le të fillojmë me rendin e ditës që është nxjerrja e  
24 materialit provues, që ZPS-ja synon të paraqesë në gjykim. ZPS-  
25 ja në parashtrimet me shkrim është shprehur se e ka kryer

1 nxjerrjen e Rregullës 102(1) (b) me përjashtim: të materialeve,  
2 në lidhje me të cilat është marrë vendim procedural kohët e  
3 fundit mbi kërkesat për masa mbrojtëse.

4 Në kuadër të Çështjes Gjyqësore Nr. 6, që janë duke u  
5 përpunuar për nxjerrje, dhe ca kërkesa të tjera, të tilla që  
6 janë ende të pazgjidhura në Çështjes Gjyqësore Nr. 6 dhe  
7 përkthimet e mbetura në gjuhën shqipe. Më duket se mbrëmë keni  
8 nxjerrë edhe një paketë. Ose mbrëmë ose sot në mëngjes keni  
9 nxjerrë dhe një paketë të fundit të përkthimeve në shqip.

10 ZPS-ja kërkon leje për të nxjerrë dy akt-ekspertiza të  
11 ardhshme kriminalistike në pajtim me Rregullën 102(1) (b). ZPS-  
12 ja ka bërë të ditur se parashikon se do të jetë në gjendje t'i  
13 nxjerrë këto akt-ekspertiza, të cilat ende nuk i ka marrë  
14 brenda datës 8 tetor, 2021.

15 I kërkoj pra palëve, që të bëjnë të ditur se kur do të  
16 kryhet nxjerrja e materialeve, për të cilat është marrë vendim  
17 procedural mbi masa mbrojtëse në kuadër të Çështjes Gjyqësore  
18 Nr. 6 nëse nuk është kryer. Nëse materialet për të cilat ka  
19 ende vendim pa marrë për masa mbrojtëse në Çështjen Nr. 6 janë  
20 apo jo pjesë e objektit, që janë objekt i kërkesës për masa  
21 mbrojtëse në Çështjen 6, që nuk është marrë vendim ende. Nëse  
22 do të kryhet përkthimi i materialit të Rregullës 102(1) (b)  
23 brenda datës 25 shtator, siç është shprehur në parashtrimet me  
24 shkrim ZPS-ja. Dhe në fund fare cilat janë arsyet për vonesën e  
25 finalizimit dhe nxjerrjes së akt-ekspertizave duke pasur

1 parasysh se aktakuza është protokolluar para më shumë se 18  
2 muajsh.

3 Z. Prokuror keni fjalën.

4 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Mikrofonin ju lutem.

5 Z. O'DOWD: [Përkthim] Faleminderit, i nderuar Gjykatës. Do  
6 t'i kundërshtoj këto pika me radhë.

7 Sa u takon materialeve që janë objekt i masave mbrojtëse,  
8 të gjitha këto, të gjithë ato që mund të ishin nxjerrë, janë  
9 nxjerrë. Ato që kanë mbetur janë ende objekt i një kërkesë që  
10 s'ka marrë ende zgjidhje në një çështje tjetër.

11 Së dyti, sa i takon përkthimeve të mbetura në shqip, i  
12 nderuari Gjykatës vërejtja me saktësi se ne e kemi nxjerrë  
13 paketën e fundit dhe këtu, me këtë mbyllet përkthimi në  
14 gjuhën shqipe i deklaratave të mëparshme të dëshmitarëve.

15 Sa u takon akt-ekspertizave, ZPS-ja më përpara i ka thënë  
16 Gjykatës, i ka bërë të ditur Gjykatës faktin se ka disa hapa  
17 hetimorë ende të pakryer, që kanë të bëjnë dhe me disa  
18 ekspertiza që i janë nxjerrë Mbrojtjes. Ne shpresonim që ta  
19 përfundojmë këtë proces brenda datës 30 korrik, por nuk patëm  
20 mundësi të kontaktonim individët përkatës. Nuk i kemi marrë  
21 ende akt-ekspertizat e tyre. I kërkojmë leje Gjykatës që të  
22 nxjerrim disa materiale të kësaj rregulle deri më 8 tetor të  
23 këtij viti.

24 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Keni marrë konfirmim se do  
25 të finalizohen këto raporte deri atëherë apo është datë synimi?

1 Z. O'DOWD: [Përkthim] Me sa jam në dijeni të paktën njëri  
2 prej këtyre raporteve është marrë dhe është duke u përpunuar në  
3 kuadër të provave. Tjetri pritet.

4 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Ti kthehem Mbrojtjes. Në  
5 përgjithësi për materialin e kësaj rregulle, Z. Gilissen.

6 Z. GILISSEN: [Përkthim] Faleminderit shumë të nderuar  
7 kolegë dhe i nderuar Gjykatës. Unë e konfirmoj atë që tha  
8 Prokurori sa i takon nxjerrjes. Unë mund të shtoj se kishim  
9 rënë dakord për një tabelë të përbashkët ku identifikojmë  
10 dokumentet -- kjo ende mbetet problem sa i takon përkthimeve në  
11 shqip që mungojnë. I nderuar Gjykatës vërej se do të marrim  
12 edhe dy akt-ekspertizat dhe do t'i marrim brenda datës 8 tetor.

13 Brenda intervistës së disa dëshmitarëve, kemi parë se  
14 përmenden disa shtojca, që i ka përdorur dëshmitari gjatë  
15 dhënies së deklaratës. Nuk i kemi marrë disa prej këtyre  
16 shtojcave ose nuk i gjenim dot në nxjerrjet e materialeve.  
17 Sigurisht kemi biseduar me ZPS-në për këtë. Ndonjëherë lidhet  
18 midis disa dokumenteve -- nuk janë shumë të qarta -- dhe jo  
19 gjithmonë arrijmë që të identifikojmë se me cilët dëshmitarë  
20 lidhen cilat dokumente. Besoj se për të gjitha këto probleme  
21 do të zhvillojmë diskutime dhe jam i sigurt që do ia dalim  
22 mbanë që të gjejmë një zgjidhje. Faleminderit shumë.

23 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Gilissen.

24 Z Prokuror, mund t'i përgjigjeni problemeve të  
25 identifikuar nga Mbrojtja?

1 Z. O'DOWD: [Përkthim] Po, i nderuar Gjykatës. Në fillim  
2 dua të them që ne vijojmë të kemi një raport pune produktiv do  
3 ta quaja unë me avokatin e Mbrojtjes. Kemi bërë një sërë  
4 komunikimesh *inter partes* dhe një takim nga afër javës që  
5 shkoi, duke u përpjekur që t'i zgjidhim problemet para se t'ja  
6 paraqesim Gjykatës.

7 Mbrojtja me këtë frymë na i paraqiti dje këto probleme  
8 duke na thënë se nuk identifikonim dot një sërë dokumentesh për  
9 të cilat s'kishin përkthime, dhe një sërë gjërash të tjera për  
10 të cilat kërkonin sqarime, për shtojca, apo prova të lidhura me  
11 transkriptin që u kemi vënë në dispozicion.

12 Jemi duke e përpunuar informacionin që na kanë dhënë se  
13 dje pasdite e kemi mësuar këtë gjë. Disa prej materialeve që ne  
14 identifikojmë se për të cilat kërkohet përkthimi, janë  
15 materiale që nuk janë deklarata të mëparshme të dëshmitarëve,  
16 por materiale të tjera. Vijojmë t'i kemi diskutime *inter partes*  
17 duke u përpjekur që t'i zgjidhim këto probleme dhe çdo problem  
18 të mbetur pastaj do ia paraqesim Gjykatës.

19 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Prokuror.

20 Z. Gilissen ju lutem.

21 Z. GILISSEN: [Përkthim] Faleminderit shumë z. Kryetar.

22 Mendoj se ka edhe diçka tjetër për këtë temë. Është çështja e  
23 incizimit audio-video të disa prej deklaratave dhe intervistave  
24 të dëshmitarëve.

25 Disa, dhe ngul këmbë disa prej intervistave nevojiten në

1 formatin video. Unë kam dhënë disa shembuj. Për shembull mungon  
2 përkthimi në pjesë të caktuara të intervistës sepse ndonjëherë  
3 ka disa gjeste që bën dëshmitari dhe kamerës i tregohen disa  
4 prova.

5 Janë të kufizuara, por mendojmë se i kemi të nevojshme.  
6 Objektivi ynë kryesor është që të shmangim pastaj konfliktet në  
7 sallën e gjyqit për këtë material. Dhe jam i sigurt që do të  
8 arrijmë një marrëveshje për këtë.

9 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Gilissen.

10 Atëherë ZPS-ja dhe Mbrojtja siç e kuptova mirë do të  
11 vijojnë që të diskutojnë *inter partes* për të zgjidhur këto  
12 probleme dhe që hë për hë ju nuk keni kërkesë nga ana e  
13 Mbrojtjes për të nxjerrë ndonjë urdhër. Kështu z. Aouini?

14 Z. AOUMI: [Përkthim] Mirëdita. Faleminderit, i nderuar  
15 Gjykatës.

16 Për këtë temë sigurisht në diskutimet tona *inter partes*  
17 ne jemi në dijeni të jurisprudencës të Tribunalit sa i takon  
18 incizimeve audio-video dhe e kemi vërejtur këtë dhe në bazë të  
19 kësaj kemi bërë diskutime me ZPS-në në mënyrë të arsyeshme të  
20 ofrojmë justifikime që shkojnë përtej verifikimit të zbardhjes  
21 së mirë të tekstit të incizuar.

22 Nëse do të mbeten arsye të vlefshme, këto mund të bihen  
23 objekt i kërkesave tona. Siç e tha dhe z. Gilissen ne do të  
24 përpiqemi që të eliminojmë sa më shumë konfliktet në mënyrë që  
25 të biem dakord drejtpërdrejt. Ua kemi dërguar dy kërkesa ZPS-së



1 dje. Ata kanë konfirmuar marrjen e këtyre kërkesave dhe do të  
2 vijojmë që të kemi diskutime *inter partes* për të gjetur  
3 zgjidhjen e duhur në mënyrë që t'i kemi këto incizime audio-  
4 video, se janë të rëndësishme për ne për të kuptuar plotësisht  
5 intervistën e këtyre dëshmitarëve pa ju drejtuar të nderuar  
6 Gjykatës.

7 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Aouini.

8 Një pyetje për Mbrojtjen.

9 Keni juve ndonjë qëndrim për të mbajtur sa i takon akt-  
10 ekspertizave kriminalistike që do të nxirren brenda datës 8  
11 tetor siç ka kërkuar Prokuroria?

12 Z. AOUINI: [Përkthim] Hë për hë nuk shohim asnjë problem.  
13 Siç e di i nderuar Gjykatës jemi të zënë, mjaft të zënë me  
14 shumë aspekte të tjera. Kështu që besoj se para datës 8 tetor,  
15 është një datë e shpejtë, kështu që do të kemi dhe shumë gjëra  
16 nëpër duar duke bërë deri atëherë.

17 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Aouini.

18 Z. Prokuror, keni diçka për të thënë për këto materiale?

19 Z. O'DOWD: [Përkthim] Shumë shkurt. Duke pasur parasysh  
20 vendimin tuaj, qëndrimi ynë është që ne nuk jemi të detyruar që  
21 të nxjerrim incizime audio-video të intervistave të  
22 dëshmitarëve. Kemi marrë kërkesën e Mbrojtjes dje. Do të  
23 punojmë nga afër me ata dhe do t'i diskutojmë këto *inter partes*  
24 dhe shpresojmë që ta zgjidhim këtë problem.

25 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Unë i mirëpres këto

1 diskutime *inter partes*. Shpresoj që shumë shpejt të arrini në  
2 marrëveshje. Përpara se ta mbyllim me këtë pikë të rendit të  
3 ditës, do të lëshoj këtë urdhër të parë gojarisht. Pasi dëgjova  
4 palët lëshoj gojarisht këtë urdhër të parë.

5 Në bazë të kërkesës së ZPS-së, pra autorizim për nxjerrje  
6 të akt-ekspertizave kriminalistike në pajtim me Rregullën  
7 102(1)(b) të Rregullores, pasi mora në shqyrtim arsyet e  
8 identifikuara nga ZPS-ja, në veçanti që këto akt-ekspertiza nuk  
9 janë finalizuar siç planifikohet fillimisht, urdhëroj ZPS-në që  
10 t'i nxjerrë akt-ekspertizat e lartpërmendura jo më vonë se data  
11 8 tetor 2021.

12 Këtu mbyllet urdhri i parë i lëshuar gojarisht.

13 Z. Prokuror, nëse nevojitet ndonjë shtyrje tjetër e afatit  
14 kohor në lidhje me nxjerrjen e materialit të Rregullës  
15 102(1)(b) në të ardhmen, ju rikujtoj që ZPS-ja duhet të kërkojë  
16 autorizim gjyqësor si zakonisht me anë të një parashtrimi të  
17 protokolluar.

18 Kalojmë tani në njoftimin e Rregullës 102(3) dhe  
19 materialit provues.

20 ZPS-ja e ka protokolluar njoftimin e Rregullës 102(3) më  
21 datë 3 shtator 2021. Mirëpo ZPS-ja ka bërë të ditur në  
22 parashtrimet e veta me shkrim se parashikon, se do t'i duhet ta  
23 plotësojë njoftimin e Rregullës 102(3) në lidhje me dy kategori  
24 materiale. Së pari, disa materiale të caktuara që janë objekt  
25 i kufizimeve të Rregullës 107. Kjo është përmendur tashmë në

1   parashtrimin e protokolluar të ZPS-së të njoftimit me datë 3  
2   shtator; dhe së dyti, materiali i identifikuar si pasojë e  
3   kontrolleve shtesë që ka bërë ZPS-ja në kuadër të procesit të  
4   verifikimit për të siguruar që janë përfshirë të gjitha  
5   materialet me rëndësi.

6           ZPS-ja ka identifikuar përafërsisht 500 materiale, që,  
7   nëse më lejohet ta them, është më shumë se një e treta më shumë  
8   sesa numri i materialeve provuese të renditura fillimisht në  
9   njoftim.

10          Përpara se ti jap fjalën ZPS-së, dua t'ju rikujtoj se në  
11   kuadër të kornizës ligjore, Gjykatësi i Procedurës Paraprake i  
12   vendos afatet për nxjerrje pasi i dëgjon palët, palët pa  
13   autorizim gjyqësor. Nuk mund të vendosin që të plotësojnë asnjë  
14   kategori të materialit provues pas afateve kohore. Kjo praktikë  
15   jo vetëm që ka mundësi ta vonojë procesin, por edhe e pengon  
16   palën kundërshtare që të bëjë përgatitjet me efikasitet për  
17   gjykim.

18          Dua që të dëgjoj nga ZPS-ja arsyet, përse i është  
19   identifikuar një numër kaq i madh materialesh provuese kaq vonë  
20   në proces.

21          Dua që ZPS-ja të bëjë të ditur nëse parashikohen kontrolle  
22   të tjera nga ana e saj në databazë për të plotësuar sërish  
23   njoftimin e Rregullës 102(3).

24          I informoj palët se nuk kam ndërmend që të nxjerr disa  
25   afate të ndryshme kohore në të ardhshmen lidhur me këtë

1 kategori të materialit provues. Dëshiroj, ose më saktë i kërkoj  
2 ZPS-së që të bëjë të ditur në këtë moment nëse tashmë e ka  
3 finalizuar shqyrtimin dhe kur pret që të ofrojë një version  
4 përfundimtar të njoftimit të Rregullës 102(3).

5 Z. Prokuror e keni fjalën.

6 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Mikrofonin ju lutem.

7 Z. O'DOWD: [Përkthim] ZPS-ja është munduar që të marrë një  
8 qasje gjithëpërfshirëse për të identifikuar materialet që duhet  
9 sipas Rregullës 102(3). Si pjesë e përpjekjeve tonë për të  
10 identifikuar këto materiale, ne kuptuam gjatë kërkimeve tona që  
11 disa nga termat, me të cilat janë bërë kërkimet nuk ishin  
12 përdorur gjatë kërkimit. Dhe në kontrollet tona rutinë, e kapëm  
13 këtë çështje para afatit, por faktikisht baza e të dhënave  
14 tona, interneti nuk punoi dhe nuk mund t'i gjenim përpara. Ne  
15 duhet t'i kishim gjetur më përpara.

16 Po tani besojmë që i kemi gjetur. I kemi identifikuar të  
17 gjithë materialet që kemi, dhe kemi dhënë listën për to në bazë  
18 të njoftimit të Rregullës 102(3).

19 Sigurisht gjatë kontrollimit të materialeve dhe  
20 dokumentacionit tonë, ne mund të identifikojmë dhe materiale të  
21 tjera por do të kërkojmë leje nga Gjykata për t'i dorëzuar ato.

22 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Prokuror, ju na keni  
23 dhënë njoftimin për materialet shtesë. Ne nuk mund të vazhdojmë  
24 në këto procedura duke bërë përditësime të vazhdueshme siç po  
25 bëni ju.

1           Është shumë e vështirë për palën tjetër që të përgatitet.  
2 Dhe ju duhet që të organizoheni. Unë kam përcaktuar afate. Unë  
3 gjithmonë i përcaktoj afatet pasi kam dëgjuar palët, dhe  
4 sidomos pasi kam dëgjuar ZPS-në. Pjesën më të madhe të kohës,  
5 unë nuk vendos afate në kundërshtim me ato që paraqisni ju,  
6 afatet që mendoni se janë të realizueshme.

7           Po dua që ta bëj të qartë, ju nuk mund të vendosni që të  
8 bëni nxjerrje materialesh kur dëshironi ju. Sepse n.q.s. bëhet  
9 kjo, procedura do të bëhet një kaos, dhe pala tjetër do të  
10 kërkojë më tepër kohë për t'u përgatitur sepse do të ketë  
11 nxjerrje të tjera.

12           Pra unë po e kuptoj nga ajo që thatë ju, që keni pasur  
13 problem me databazën tuaj, e kuptoj. Por duhet të jetë e qartë  
14 se duhet të kërkonit leje nga Gjykata përpara sesa të bëni  
15 dorëzimin e materialeve të tjera.

16           Pra, ju thatë që shumica e materialeve janë përfshirë në  
17 listë dhe ju po thoni gjithashtu që mund të keni materiale të  
18 tjera provuese në të ardhmen. Dhe n.q.s. do i dorëzoni ato  
19 duhet t'i shpjegoni Gjykatës se pse nuk ishin futur këto  
20 materiale në listë.

21           Z. O'DOWD: [Përkthim] Faleminderit i nderuar Gjykatës. E  
22 kuptojmë plotësisht.

23           GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Tani e ka fjalën Mbrojtja.

24           Z. GILISSEN: [Përkthim] Faleminderit i nderuar Kryetar.

25 Për sa i përket materialeve që ka në zotërim ZPS-ja ne kërkojmë

1 të kemi qasje në to, sepse kanë lidhje me përgatitjen tonë. Ne  
2 kemi marrë njoftim të arsyeshëm për datën që është përcaktuar  
3 përpara sesa palët të bëjnë një tabelë Excel për të punuar me  
4 të. Dhe kjo do të ishte shumë më e volitshme për të gjitha  
5 palët.

6 Sigurisht unë e di që ka terma të reja. Nuk dua të them që  
7 tani që do të na duhet më tepër kohë, sepse është shumë herët.  
8 Por nëse do të mundemi të japim indikacionin tonë më herët, do  
9 ta bëjmë këtë. Por duhet ta diskutojmë me z. Shala sigurisht,  
10 në bazë të gjërave që do të marrin, në bazë të dokumenteve që  
11 do të na nxirren. Pra është herët për të dhënë pozicionin tonë.

12 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Një çështje për  
13 transkriptin. Ju më duket se thatë, janë shumë "dokumente" dhe  
14 transkripti e shkruajti ka shumë "stazhierë" dhe ky është një  
15 gabim. Kjo duhet të korrigjohet.

16 Z. GILISSEN: [Përkthim] Kërkoj ndjesë. E di që anglishtja  
17 ime s'është aq e mirë.

18 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Gjykatësi e vlerëson këtë.

19 Z. Aouini, vetëm disa hollësi në lidhje me njoftimin. Ne  
20 kemi rënë dakord me Prokurorinë për një lloj protokolli. Ne do  
21 të ndajmë me njëri-tjetrin një tabelë Excel, që do të ketë  
22 dokumentet. Ne i sugjeruam ZPS-së, që t'i njëjtojmë diskutimet  
23 tona dhe do të përdorim një tabelë të vetme, ku ato mund të  
24 shënojnë gjëra për ne dhe të bëjnë komente, në mënyrë që të mos  
25 ketë diskutime dhe debate më vonë në lidhje me çështjet, ose të

1 ketë debate minimale.

2 Ne besojmë që kjo do të ishte një mënyrë më efektive e  
3 përdorimit të kohës për dorëzimin dhe marrjen e dokumenteve  
4 sipas Rregullës 102(3). Sigurisht ne e dimë që do të vinë  
5 materiale të tjera, dhe do t'i kushtojmë shumë vëmendje nëse  
6 ato materiale përfshihen në Rregullën 102(1) (a) apo 103.

7 Por indikacioni i parë është që ndërkohë ne do t'i  
8 kërkojmë ZPS-së informacion shtesë për materialet që përfshihen  
9 në njoftim. Z. Gjykatës e dini që ne e kemi marrë këtë  
10 njoftimin dhe është në aneks. Po disa nga përshkrimet nuk janë  
11 aq të dobishme për ne për të vlerësuar në mënyrë të duhur nëse  
12 ka lidhje apo është e rëndësishme, (apo nëse ajo temë ka  
13 rëndësi) është juridikisht thelbësore për ne. Pra ne kemi rënë  
14 dakord me ZPS-në që t'i bëjmë të gjitha këto diskutime  
15 paraprake për këto temat. Kërkojmë informacion shtesë dhe  
16 n.q.s. ne do të mund të japim indikacionet tona për këto  
17 materiale në grupe dokumentash, apo paketa dokumentash, do ta  
18 bëjmë këtë në mënyrë që të mos pengojmë procesin dhe  
19 protokollimin e tyre. Pra do t'i zgjidhim çështjet teksa dalin  
20 me kalimin e kohës.

21 Pra kaq kishim për të thënë në lidhje me njoftimin. Nëse  
22 ato materialet e tjera do të kenë një ndikim të caktuar, do  
23 t'ju bëjmë kërkesë të arsyeshme ju, duke pasur parasysh që tek  
24 ju do të vijmë vetëm n.q.s. çështja nuk është zgjidhur midis  
25 palëve.

1 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Aouini dhe  
2 faleminderit të dy palëve që kanë vendosur një marrëdhënie të  
3 tillë pune. Unë mendoj që është në interes të të gjithëve që të  
4 mbahet komunikimi i hapur.

5 Z. Prokuror, të kalojmë tek kategoria tjetër. Nuk e di  
6 deshët të shtonit diçka në lidhje me këtë pikë?

7 Z. O'DOWD: [Përkthim] Kjo është hera e parë që dëgjuam që  
8 ka probleme me përshkrimin e dokumenteve dhe do ta diskutojmë  
9 me palën tjetër për ta zgjidhur atë sa më shpejt.

10 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

11 Të kalojmë tani në materialin tani 103.

12 Në parashtrimet me shkrim ZPS-ja tha që ka dhënë deri tani  
13 dy paketa me dokumente të Rregullës 103 dhe po shikon nëse ka  
14 materiale të tjera për të dorëzuar. Unë dëshiroj të di nëse  
15 mbeten materiale shfajësuese që ka në kontrollin e vet  
16 Prokuroria, të cilat duhet t'i jepen Mbrojtjes në bazë të  
17 Rregullës 103, më falni dhe nëse ka kërkesa për masa mbrojtëse.

18 Z. O'DOWD: [Përkthim] Prokurori ka nxjerrë dy paketa  
19 materiale deri tani. Ne po shikojmë nëse ka materiale të tjera  
20 shfajësuese. Dhe ne do të kërkojmë dhe do t'i nxjerrim këto  
21 materiale ndërkohë që i identifikojmë.

22 Ne besojmë që ka materiale të tjera të Rregullës 103 në  
23 dispozicionin tonë. Ne po kërkojmë në mënyrë aktive dhe do t'i  
24 nxjerrim ato. Për masat mbrojtëse nuk kemi ndonjë kërkesë  
25 iminente për to, por nëse do t'i identifikojmë do ta bëjmë



1 kërkesën.

2 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Gilissen.

3 Z. GILISSEN: [Përkthim] Faleminderit z. Gjykatës. E  
4 konfirmoj që kemi marrë dy paketa sipas Rregullës 103. Po  
5 presim të marrim pjesën tjetër të materialeve. Dhe mund të them  
6 vetëm kaq sa më shpejt që të jetë e mundur aq më mirë.

7 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Atëherë, kjo do të jetë moto  
8 për të ardhmen: Sa më shpejt, aq më mirë.

9 Z. Prokuror, keni diçka tjetër për të shtuar?

10 Z. O'DOWD: [Përkthim] Jo.

11 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Atëherë të kalojmë në  
12 materialin e Rregullës 107. Në parashtrimin me shkrim ZPS-ja  
13 tha se përveç materialeve të Rregullës 102(3) që u diskutua më  
14 herët, nuk ka materiale të tjera në bazë të Rregullës 107 që të  
15 jenë identifikuar. Desha të di nëse palët kanë ndonjë  
16 vështirësi, apo parashikojnë të kenë ndonjë vështirësi në  
17 lidhje me këto lloj materialesh.

18 Z. O'DOWD: [Përkthim] Po është e saktë. Nuk kemi  
19 materiale të tjera në bazë të Rregullës 102, 107 më falni,  
20 përveç atyre që diskutuam në Rregullën 102(3).

21 Në lidhje me këto materiale, numri i tyre është rreth 30  
22 dokumente, të cilat do të kenë kufizime sipas Rregullës 107.

23 Dhe ju them i Nderuar Gjykatës, shumica e këtyre  
24 dokumenteve lidhen me çështjen e konfliktit të armatosur sesa  
25 me çështjet materiale të këtij gjykimi. Ne vazhdojmë të punojmë

1 me dhënësin e këtyre materialeve.

2 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Sa më shpejt të jetë e  
3 mundur dhe sa më shpejt aq më mirë.

4 Z. Gilissen.

5 Z. GILISSEN: [Përkthim] Nuk dua të përsëris të njëjtën gjë  
6 por është pikërisht ajo që thatë ju, Sa më shpejt, aq më mirë.

7 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Gilissen. A  
8 ka ndonjë nga palët diçka për të thënë në lidhje me procesin e  
9 materialeve? Jo, jo?

10 Atëherë të kalojmë në çështjen e përkthimit të materialeve  
11 të parashtrimet të protokolluara dhe të provave. Mbrojtja ka  
12 thënë që ka bërë një kërkesë për prioritizimin e përkthimit të  
13 disa materialeve.

14 Dua të dëgjoj nga palët nëse kanë vështirësi me çështjen e  
15 përkthimit.

16 Dhe si fillim dua të dëgjoj nga Mbrojtja.

17 Z. Aouini.

18 Z. AOUBINI: [Përkthim] Siç e kemi thënë dhe më herët i kemi  
19 dërguar korrespondencë ZPS-së ku kemi identifikuar numrin e  
20 përkthimeve që mungojnë ose në shqip ose në anglisht ose në të  
21 dyja gjuhët. Kjo është diçka për të cilën kemi rënë dakord dhe  
22 i kemi hartuar një tabelë dhe do t'i krahasojmë dhe do t'i  
23 përditësojmë ndërkohë që marrim materiale të tjera.

24 Disa nga problemet që kemi ne, është që për disa kategori  
25 dokumentesh që vijnë nga një burim i caktuar, për shembull,

1 dokumente nga gjuhë të ndryshme janë me numër ERN të ndryshme.  
2 Dhe nuk jemi mësuar me këtë mënyrë sepse ERN-ja është e njëjtë  
3 për një gjuhë të caktuar.

4 Dhe na duhet ndihmë në këtë rast sa herë që nuk e gjejmë  
5 një dokument. Dhe e kemi futur. Sa herë e kemi gjetur një  
6 dokument të tillë e futim në tabelë për t'ia dhënë ZPS-së. Pra  
7 shpresojmë që t'i zgjidhim të gjitha problemet në lidhje me  
8 përkthimin nëpërmjet këtij procesi. Nuk kemi ndonjë shqetësim  
9 tjetër në lidhje me përkthimin.

10 GJYKATËSI GUILLOU: Faleminderit, z. Aouini.

11 Prokuroria.

12 Z. O'DOWD: [Përkthim] Shumë shkurtimisht konfirmoj se e  
13 kam marrë listën e problemeve të përkthimit dhe do t'i  
14 diskutojmë në të ardhmen dhe do t'i zgjidhim duke i diskutuar  
15 me njëri-tjetrin në të ardhmen.

16 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Prokuror.  
17 Vërej që ju po punoni për këtë dhe sa më shpejt aq më mirë siç  
18 e thashë.

19 Më pëlqen kjo thënia juaj z. Gilissen. Besoj që do ta bëj  
20 një nga fjalitë që do ta përdor më shumë në të gjitha seancat e  
21 ardhshme -- sidomos kur kthehem në anën e djathtë të kësaj  
22 salle.

23 Tani kalojmë tek pika e tretë në rendin e ditës që janë  
24 hetimet ende të papërfunduara të ZPS-së.

25 Prokuroria në parashtrimet e saj ka thënë që, -- ka

1 kërkuar zgjatjet e afatit deri në 28 janar 2022 për dorëzimin e  
2 dosjes para-gjyqësore duke pretenduar se çështja është  
3 komplekse dhe që mund të ketë përplasje afatesh me çështje të  
4 tjera.

5 Unë ju kujtoj se gjatë Konferencës së Dytë për Ecurinë e  
6 Çështjes, ZPS-ja konfirmoi që do ta dorëzonte dosjen paraprake  
7 më 19 nëntor 2021.

8 Pra z. Prokuror, ju e keni dorëzuar aktakuzën 18 muaj  
9 përpara dhe tani kërkonti që ta shtyni dorëzimin e dosjes  
10 paraprake dy vjet më vonë, ose pak më shumë se 23 muaj që të  
11 jem më i saktë.

12 Ju duhet më shumë kohë për të përgatitur dosjen paraprake,  
13 sepse unë nuk shoh ndonjë lidhje të qartë midis nxjerrjes së  
14 materialeve sipas Rregullës 102(3), materiale të cilat ju nuk  
15 keni ndërmend t'i përdorni në gjykim dhe finalizimit të dosjes  
16 paraprake, që i referohet materialeve të cilat ju do t'i  
17 përdorni, provave që do t'i përdorni në gjykim.

18 Ju gjithashtu në parashtrimin me shkrim thatë, kërkuat që  
19 doni të zgjeroni periudhën midis dorëzimit të dosjes paraprake  
20 dhe protokollimit të tabelës sipas Rregullës 109(c). A mund të  
21 na thoni pse nuk mund të përgatitet kjo tabelë më përpara?  
22 Përpara sesa të dorëzohet dosja paraprake?

23 Z. O'DOWD: [Përkthim] Faleminderit. Ne besojmë që periudha  
24 që jemi kërkuar, zgjatja e afatit të dorëzimit është deri në 28  
25 janar është e nevojshme sepse është një çështje e thjeshtë e

1 burimeve njerëzore dhe kapaciteteve që kemi. Burimet që na  
2 kërkohen për t'ju përgjigjur kërkesave të Rregullës 102(3) janë  
3 të konsiderueshme dhe mendoj që është një ngarkesë pune shumë e  
4 madhe. Ne do të përpiqemi që t'i përmbahemi afateve dhe për sa  
5 i përket tabelës, do të përpiqemi që të mbajmë të njëjtën  
6 distancë midis dorëzimit të saj dhe dosjes paraprake.

7 Megjithatë ne do t'i përmbahemi çfarëdolloj afati që do të  
8 vendosni i nderuar Gjykatës, po besojmë që është e nevojshme  
9 zgjatja e afatit për t'i trajtuar gjithë këto probleme.

10 Për sa i përket tabelës sipas Rregullës 109, është e  
11 pamundur që të hartohet ajo përpara se të dorëzohet dosja  
12 paraprake sepse ato materiale që kërkohen sipas Rregullës 109  
13 dhe 95(4) janë pak a shumë të njëjta. Kështu që neve na duhet  
14 që të kategorizojmë dhe të analizojmë provat që do të përdorim.

15 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Prokuror.  
16 Ti kthehem tani z. Gilissen për sa i përket afateve që propozon  
17 Prokuroria.

18 Z. Gilissen duhet të them që dorëzimi i dosjes paraprake  
19 më shumë se 23 muaj pas dorëzimit të aktakuzës është një kohë  
20 shumë e gjatë. Unë doja ta theksoj këtë problem.

21 Unë i kuptoj shumë mirë vështirësitë, megjithatë është  
22 kohë mjaft e gjatë kjo për z. Shala, i cili ka marrë akuzat dhe  
23 është në burg. Dhe z. Aouini do t'i shtjellojë më tej këto ide.

24 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim]

25 Z. Alouini.

1 Z. AOUINI: [Përkthim] Faleminderit i Nderuar Gjykatës.

2 Qëndrimi ynë është që shtyrja e afatit në mënyrë të  
3 arsyeshme nuk është shumë e dëmshme në këtë fazë sepse ne po e  
4 përdorim këtë kohë në mënyrë efektive dhe në mënyrë intensive  
5 për tu përgatitur nga ana jonë.

6 Megjithatë, ju falënderojmë për indikacionet që jemi në  
7 lidhje me afatet që do të vihen në këtë kontekst, por nuk do të  
8 bëjmë parashtrime të mëtejshme në lidhje me këtë. Siç e thashë  
9 sa më shpejt aq më mirë, siç u tha vazhdimisht këtu. Ne kemi  
10 parasysh edhe që do të ketë pushime të dimrit Gjykata kur nuk  
11 do të punohet, por siç e tha dhe z. Gilissen ato janë ditë të  
12 cilat z. Shala do t'i shpenzojë në burg, do t'i kalojë në burg.  
13 Prandaj sa më shpejt të fillojë gjykimi aq më mirë.

14 Ne thamë, e kemi thënë që nuk kundërshtojmë shtyrjet e  
15 afateve që janë të arsyeshme dhe të përlligjura. Por do ta lëmë  
16 deri këtu në këtë moment sepse kemi besim që po përgatitemi  
17 ndërkohë dhe do të jemi në gjendje që t'i trajtojmë çështjet që  
18 ngrihen në dosjen paraprake dhe në tabelën sipas Rregullës 109.  
19 Por besoj që kjo mund të bëhet edhe në një afat më të shkurtër  
20 sesa kanë propozuar ata. Megjithatë ju i nderuar Gjykatës do ta  
21 përcaktoni atë.

22 Në lidhje me tabelën ne e kuptojmë vështirësinë për bërjen  
23 e një përmbledhjeje të gjitha referencave, dhe të gjitha ato  
24 referenca duhet të vendosen në mënyrën e duhur. Siç e thamë dhe  
25 dje, duhet që të jemi në gjendje të vendosim lidhjen midis

1 dokumenteve, vendeve ku janë dokumentet në kontekst dhe  
2 dokumenteve dhe dëshmitarit.

3 Dhe kjo tabelë është shumë e rëndësishme për ne. Dhe siç e  
4 thamë në Konferencën e Parë për Ecurinë e Çështjes ne besojmë  
5 që të njëjtat afate duhet të zbatohen edhe për Mbrojtjen kur të  
6 dorëzojë dosjen e vet paraprake.

7 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Aouini.

8 D.m.th. ju nuk e kundërshtoni kërkesën e Prokurorisë për  
9 zgjatjen e afatit për dorëzimin e dosjes paraprake. E di që  
10 rapëlqeni që ta keni sa më shpejt këtë dosje të dorëzuar por  
11 nuk e kundërshtoni kërkesën?

12 Z. AOUINI: [Përkthim] Pikërisht ashtu i nderuar Gjykatës  
13 nuk është një kundërshtim si i tillë por do të përdor moton e  
14 ditës, sa më shpejt, aq më mirë. Mendoj që nuk duhet të humbim  
15 kohën që kemi në dispozicion. Është një material shtesë, një  
16 njoftim shtesë për Mbrojtjen që mund ta bëjë punën tonë më  
17 efektive.

18 Përsëri edhe ne nga ana jonë do të kemi probleme me  
19 shtyrjen e afateve dhe ndoshta do të kemi kërkesa të tilla para  
20 jush. Edhe ne ua lëmë juve i nderuar Gjykatës që këto afate t'i  
21 caktoni ju. Por jo të shtyhen më shumë se data që kërkon vetë  
22 Prokuroria.

23 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Aouini.

24 Mendoj se Mbrojtja ka një përqasje mjaft konstruktive dhe nuk  
25 kundërshton shtyrjen e afateve me kusht që nxjerrja e

1 materialeve të bëhet në mënyrë efikase dhe në mënyrë  
2 bashkëpunuese. Dhe ashtu sikur se thanë avokatët e Mbrojtjes me  
3 hollësitë e nevojshme në mënyrë që të mund të përgatisin  
4 Mbrojtjen e klientit të tyre me efikasitet.

5 A keni ju ndonjë gjë tjetër për të thënë mbas  
6 parashtrimeve të Mbrojtjes?

7 Z. O'DOWD: [Përkthim] Jo, kaq kishim ne.

8 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Prokuror.

9 Tani do të lëshoj dhe një urdhër të tretë me gojë.

10 Urdhër të dytë gojor, më falni, pasi kam dëgjuar palët.  
11 Dhe duke marrë parasysh kërkesën e ZPS-së për ndryshimin e  
12 afateve për dorëzimin e dosjes paraprake dhe të tabelës sipas  
13 Rregullës 109(c) dhe pasi kam marrë parasysh arsyet e  
14 identifikuar nga ZPS-ja, veçanërisht nevojën për të pasur një  
15 farë radhitje kohore të procesit të nxjerrjes së materialeve  
16 dhe të dorëzimit të dosjes paraprake dhe tabelës sipas  
17 Rregullës 109(c), duke marrë parasysh edhe faktin që Mbrojtja  
18 nuk kundërshton ndryshimin e kërkuar të afateve, në bazë të  
19 arsytimit se ka nevojë për më shumë kohë që të përgatisë  
20 provat e veta, urdhëroj Prokurorinë që dosjen e vet paraprake  
21 ta dorëzojë jo më vonë se data 28 janar 2022, dhe ta dorëzojë  
22 tabelën sipas Rregullës 109(c) jo më vonë se data 11 shkurt  
23 2022.

24 Me kaq përfundon urdhri i tretë [siç u përkthye] gojor që  
25 lëshova sot.



1 Në lidhje me pikën me radhë në orarin për sot, i drejtohem  
2 Mbrojtjes dhe hetimeve.

3 Nga parashtrimet me shkrim të Mbrojtjes e kam parasysh që  
4 do të kryhen hetime për të paraqitur mbrojtjen e tyre. Mbrojtja  
5 ka paraqitur vështirësi që ka hasur gjatë kryerjes së hetimeve  
6 në terren.

7 Do të ftojme Mbrojtjen tani që të elaborojnë pak për këto  
8 vështirësi.

9 z. Gilissen ju keni thënë në parashtrimet me shkrim se për  
10 momentin nuk jeni në gjendje të konfirmoni nëse do të bëni  
11 kërkesë për mundësi të posaçme hetuese, se nuk jeni në gjendje  
12 të tregoni nëse do të bëni njoftim për alibi apo për arsye të  
13 tjera që përjashtojnë përgjegjësi penale. Dhe se në këtë fazë  
14 nuk mund të konfirmoni n.q.s. do ta dorëzoni dosjen tuaj  
15 paraprake dhe materialin mbështetës brenda një afati të  
16 caktuar.

17 A mund të na thoni më konkretisht se si i keni parashikuar  
18 afatet për këto hapa proceduralë dhe duhet që Prokuroria ta  
19 dorëzojë dosjen e vet paraprake që ju pastaj të mund t'ju  
20 përgjigjeni këtyre kërkesave.

21 Urdhëroni z. Gilissen.

22 Z. GILISSEN: [Përkthim] Faleminderit i nderuar Gjykatës.

23 Ne e kemi ditë që në fillim se nuk do ta kemi të lehtë  
24 kryerjen e hetimeve në terren.

25 E pranoj që nuk e kishim parashikuar sesa më të vështira

1 do të ishin ato vështirësi. Por mund të them se tani ka  
2 përmirësime. Kemi gjetur disa hetues dhe humbëm shumë kohë më  
3 parë, por gjërat janë duke shkuar në drejtimin e duhur. Pra ka  
4 përmirësim.

5 Mund t'ju shpjegojmë me hollësi se çfarë vështirësish  
6 kemi. Por nuk dua ta bëj këtë në seancë private, se është pak a  
7 shumë një çështje delikate. Për ne është më mirë që të marrim  
8 një herë dosjen e Prokurorisë sepse atëherë do të jemi të  
9 informuar për të gjithë elementët e nevojshëm që ne duhet t'i  
10 trajtojmë.

11 Kur do të kemi informacion sigurisht që do t'ju drejtohem  
12 juve i nderuar Gjykatës. Përsëri po e përfundoj me moton e  
13 ditës, sa më shpejt aq më mirë.

14 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Gilissen.

15 N.q.s. preferoni që t'i drejtoheni Gjykatës në seancë  
16 private ose me një farë parashtrimi me shkrim *ex parte* atëherë  
17 këtë mund të na e bëni të ditur në javët që do të vijjnë. Pra  
18 lirisht mund të më drejtoheni lidhur me këtë aspektin. Ne do të  
19 përpiqemi që t'i zgjidhim këto probleme sidomos ato praktike me  
20 të cilat ballafaqoheni në terren.

21 Z. Prokuror, a keni diçka për të shtuar në lidhje me  
22 parashtrimet e Mbrojtjes.

23 Z. O'DOWD: [Përkthim] Jo, në këtë moment.

24 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Prokuror.

25 Tani do të kalojmë në pikën në vijim të rendit të ditës

1 për sot që janë pikat në lidhje me faktet dhe ligjit, për të  
2 cilat palët kanë rënë dakord. Kërkoj nga palët që të më bëjnë  
3 të ditur n.q.s. presin që t'më parashtrojnë një listë në lidhje  
4 me pikat që janë diskutabile dhe ato që nuk janë. Në lidhje me  
5 këto e di që palët po zhvillojnë diskutime paraprake në lidhje  
6 me mundësinë e dorëzimit të këtyre pikave për të cilat ato kanë  
7 rënë dakord. Dhe kërkoj prej jush një herë z. Prokuror që të na  
8 jepni një farë ideje për afatet.

9 Z. O'DOWD: [Përkthim] Për momentin nuk di, nuk mund t'ju  
10 jap një kuadër për afatet, por me identifikimin e pikave që i  
11 kemi të përbashkëta, atëherë me siguri do të paraqesim një  
12 parashtrim të tillë përpara dosjes paraprake.

13 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

14 Z. Gilissen.

15 Z. GILISSEN: [Përkthim] Po, z. Kryetar. Kemi filluar  
16 diskutimet paraprake me Zyrën e Prokurorisë. Presim prej atyre  
17 një propozim apo propozime lidhur me këto pika për të cilat  
18 duhen palët të bihen dakord. Kur ta marrim një listë të tillë  
19 propozimesh atëherë në konsultim me z. Shala do të mund që të  
20 bëjmë deklaratat tona të mëtejshme.

21 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Gilissen, mendoni që një  
22 pajtim i këtillë midis palëve lidhur me pikat juridike dhe ato  
23 faktike, mund të arrihet përpara dorëzimit të dosjes paraprake  
24 apo pas?

25 Z. AOUBINI: [Përkthim] Ju faleminderit i Nderuar Gjykatës.

1 Mendoj që Zyra e Prokurorit ua bëri të ditur që janë  
2 optimistë që mund të arrijmë një marrëveshje të tillë lidhur me  
3 pikat faktike dhe ato juridike deri në dorëzimin e dosjes  
4 paraprake.

5 Ju e keni gjithsesi të qartë i nderuar Gjykatës se vendimi  
6 përfundimtar në lidhje me këto pika është vendimi i z. Shala.  
7 Ne do të presim njëherë që këto pika të identifikohen. Ne do  
8 t'ia dorëzojmë ato në mënyrën e shpejtë dhe të duhur z. Shala.

9 Do ta njoftojmë atë për ndikimin e mundshëm të secilës  
10 prej atyre pikave në zhvillimin e procedurave, dhe kur të  
11 dëgjojmë vendimin e tij në lidhje me ato pika, atëherë vendimin  
12 do ua komunikojmë Prokurorit dhe juve z. Gjykatës. Besoj që iu  
13 përgjigja pyetjes suaj i Nderuar Gjykatës.

14 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Absolutisht po. Faleminderit  
15 z. Aouini.

16 Prokuror, a keni diçka për të shtuar?

17 Z. O'DOWD: [Përkthim] Jo, i Nderuar Gjykatës.

18 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Prokuror.

19 Atëherë të kalojmë tek pika tjetër e rendit të ditës që  
20 është çështjet lidhur me paraburgimin. Kërkoj nga përfaqësuesi  
21 i Zyrës Administrative të na japë informacion të përditësuar në  
22 lidhje me këtë n.q.s. takimet midis mbrojtësit dhe të akuzuarit  
23 në objektin e paraburgimit, tani janë kthyer në normale, pra në  
24 situatën si kanë qenë para pandemisë; edhe n.q.s. Zyra  
25 Administrative ka vazhduar me kryerjen e vizitave familjare.

1           Z. ROCHE: [Përkthim] Nuk do t'i përsëris të gjitha ato që  
2 kemi bërë në parashtrimin me shkrim, por takimi fizik midis  
3 mbrojtësit dhe klientit është mundësuar, është kthyer në  
4 regjimin para pandemisë për sa i përket vizitave personale ose  
5 me anëtarë të familjes, të afërm të familjes. Këto vizita kanë  
6 vazhduar që nga data 15 korrik. Nga 6 shtatori janë të mundshme  
7 edhe vizitat personale. Dhe mendoj që vizitat në lidhje me z.  
8 Shala janë caktuar për këtë muaj apo për muajin që vjen.

9           GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Roche.  
10          Tani do t'i kthehem Mbrojtjes.

11          A keni diçka për të ngritur lidhur me paraburgimin?

12          Z. GILISSEN: [Përkthim] Ju faleminderit i nderuar  
13 Gjykatës. Është një çështje mjaft e ndjeshme kjo si çdo herë.  
14 Dua ta falënderoj Zyrën Administrative për përpjekjet që kanë  
15 bërë dhe për informacionin që dhanë sot. Ne e monitorojmë në  
16 vazhdimësi situatën me z. Shala. Ai na informon dhe ne e marrim  
17 këtë informacion për çështjet që ngre ai. (E di që) Bëjmë të  
18 ditur se ai është ballafaquar me disa probleme.

19          Ne jemi me kontakt të vazhdueshëm me zyrtarët e Zyrës  
20 Administrative përfshirë vetë Administratorin, dhe dua që ti  
21 falënderoj për disponueshmërinë e tyre dhe ndihmën ndaj nesh  
22 dhe z. Shala. E besoj që kjo çështje për të cilën kemi problem  
23 do të zgjidhet dhe se gjendja do të përmirësohet me vullnetin e  
24 mirë të gjithë palëve pjesëmarrëse.

25          Pra presim që në të ardhmen çfarë do të ndodhë, por mendoj

1 që tani për tani gjërat po përmirësohen. Kemi hasur në disa  
2 incidente për momentin nuk është koha për t'i diskutuar ato  
3 incidente në seancë publike.

4 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

5 Z. Roche, a keni diçka për të shtuar?

6 Z. ROCHE: [Përkthim] Vetëm desha të shtoj se dialogu i  
7 drejtpërdrejtë midis Sekretarisë dhe Mbrojtjes vazhdon dhe  
8 besoj që do të zgjidhet për çështjet e identifikuara.

9 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

10 Tani do i kërkoj palëve të më bëjnë të ditur n.q.s. kanë  
11 edhe ndonjë çështje tjetër për të ngritur.

12 Z. O'DOWD: [Përkthim] Jo nuk kemi asgjë në këtë moment për  
13 të ngritur, i nderuar Gjykatës.

14 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

15 Z. Gilissen.

16 Z. GILISSEN: [Përkthim] Po, i nderuar Gjykatës. E di që e  
17 kam pak si vonë por do t'ju bëj një kërkesë gojore.

18 Me lejen tuaj dhe nën kontrollin tuaj si kryetar do e marr  
19 përgjegjësinë mbi vete për problemin që e kemi.

20 Jemi në procesin të finalizimit të përgjigjes tonë me  
21 shkrim ndaj mocioneve paraprahe. E kemi të qartë mentalisht  
22 se numri i lejuar i fjalëve është pak si i ulët për ne. Kërkoj  
23 prej jush që të na lejoni që rritjen e numrit të lejuar të  
24 fjalëve nga 2000 për mocion.

25 Ju sigurisht që duhet të keni parasysh atë faljen që

1 kërkojmë ne, që këtë kërkesë e bëjmë me vonesë, por shtimi i  
2 numrit të fjalëve do të shtojë edhe cilësinë e debatimit që  
3 bëhet në këto mocione me shkrim. Prandaj dhe morëm guximin që  
4 t'jua bëjmë këtë kërkesë me gojë në këtë fazë të vonshme.

5 Besoj që me 2000 më shumë fjalë ne do të jemi në gjendje  
6 t'i përgjigjemi parashtrimeve të Mbrojtjes në mënyrë më  
7 efektive dhe më cilësore.

8 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Gilissen.

9 Atëherë ju kam kuptuar qartë nga kërkesa që bëtë  
10 gojarisht, se doni të parashtroni kundërpërgjigjen në  
11 përgjigjen e Prokurorisë për secilën përgjigje veç e veç. Pra  
12 n.q.s. kërkonte shtim nga 2000 fjalë për secilën kundërpërgjigje  
13 apo kërkonte 2000 për të dyja kundërpërgjigjet. Dhe a do të  
14 mjaftojnë le të themi, 5000 fjalë gjithsej për të dyja  
15 kundërpërgjigjet?

16 [Avokati i Mbrojtjes këshillohet]

17 Z. AOUBINI: [Përkthim] Më falni i nderuar Gjykatës.

18 Ne punojmë si binjakë dhe do ta kompletoj unë këtë kërkesë të  
19 z. Gilissen.

20 Kemi ndërmend që të dorëzojmë dy përgjigje ndaj përgjigjes  
21 së Prokurorisë për kundërshtimin e juridiksionit dhe të formës  
22 së aktakuzës. Ne mendojmë që do të na duhen më shumë fjalë për  
23 t'ju përgjigjur parashtrimeve të Prokurorisë. N.q.s. na jepni  
24 një numër të përgjithshëm shtesë prej 5000 fjalëve, atëherë do  
25 të jemi falënderues. Më shumë fjalë do të na duhen për

1 kundërpërgjigjen në lidhje me përgjigjen e Prokurorisë ndaj  
2 mocionit tonë për mungesë të juridiksionit, dhe besoj që ky  
3 numër shtesë do të na ndihmojë që parashtrimet tona t'i  
4 paraqesim në mënyrë më të qartë dhe më cilësore.

5 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Pra, ju kërkonit shtim të  
6 numrit të lejuar të fjalëve për çdo kundërpërgjigje, dhe e  
7 dyta, kërkonit të paktën gjithsej 5000 fjalë dhe më shumë për  
8 kundërpërgjigjen në lidhje me çështjen e juridiksionit. Pra  
9 rreth 3000 vetëm për të dytën. Pra a është kështu?

10 Z. AOUBINI: [Përkthim] Po, e çojmë shumë këtë. E dimë që e  
11 kemi pak vonë këtë kërkojmë kërkesë të parashtruar. Po  
12 përpiqemi që t'i përmbledhim gjërat në kundërpërgjigjen tonë,  
13 mirëpo për mendimin tonë ky numër shtesë i fjalëve është i  
14 nevojshëm -- më e dobishme.

15 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Sa më shpejt, aq më mirë  
16 është çdo herë mirë. Por nuk do të kisha thënë sesa më i gjatë  
17 është një parashtrim, aq më i mirë është ai. Nuk është çdo herë  
18 ashtu. A keni ju diçka për të kundërshtuar, apo për të ngritur  
19 një kundërshtim lidhur me kërkesën e Mbrojtjes, z. Prokuror?

20 Z. O'DOWD: [Përkthim] Jo nuk kam, i nderuar Gjykatës.

21 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Ju faleminderit.

22 Z. Gilissen, Z. Aouini, a keni diçka për të shtuar?

23 Z. GILISSEN: [Përkthim] Jo, ju faleminderit shumë z.

24 Kryetar.

25 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Atëherë do të jap vendimin



1 tim në lidhje me kërkesën për shtimin e numrit të lejuar të  
2 fjalëve me kërkesën e juaj.

3 Gjykoj se janë treguar arsye të forta që justifikojnë për  
4 ligjin shtimin e lejuar të fjalëve për t'i mundësuar Mbrojtjes  
5 të kundërpërgjigjet në përgjigjen e Mbrojtjes ndaj mocionit  
6 paraprak të Mbrojtjes, për mungesë juridiksioni dhe atë për  
7 formën e aktakuzës.

8 Unë e mbaj parasysh argumentin e Mbrojtjes se ka nevojë që  
9 t'i argumentojë siç duhet parashtrimet e paraqitura në këto dy  
10 mocione.

11 Kam miratuar një kërkesë të ngjashme më 3 shtator 2021.  
12 Kësaj radhe të paraqitur nga ZPS-ja dhe gjithashtu kam parasysh  
13 që Prokuroria nuk e kundërshton këtë kërkesë të Mbrojtjes.

14 Në përputhje me këtë, autorizoj kërkesën e Mbrojtjes për  
15 shtimin e numrit të fjalëve. Përkatësisht, miratoj që  
16 parashtrimi i kundërpërgjigjes të Mbrojtjes të mos jetë më i  
17 gjatë se 6000 fjalë secili.

18 Me kaq përfundoj urdhrin gojor.

19 Tani do t'ju kërkoj palëve që të mi tregojnë mendimet e  
20 tyre në lidhje me mbajtjen e Konferencës së Katërt për Ecurinë  
21 e Çështjes dhe kemi një farë date të paracaktuar për 15 nëntor.  
22 A janë palët e disponueshme atëherë?

23 Z. O'DOWD: [Përkthim] Po, jemi.

24 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Ju faleminderit.

25 Z. Gilissen.

1 Z. GILISSEN: [Përkthim] Po, është plotësisht e  
2 përshtatshme kjo datë e propozuar për ne.

3 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Ju faleminderit.

4 Atëherë do të merrni një vendim për caktimin e datës. Aty  
5 do të jetë edhe rendi i ditës për atë Konferencë për Ecurinë e  
6 Çështjes.

7 Do t'ju kërkoj gjithashtu palëve që parashtrojnë me shkrim  
8 çdo çështje që duan të ngrenë gjatë asaj Konference të Katërt.

9 N.q.s. ju z. Gilissen parashikoni vështirësi në kryerjen e  
10 hetimeve, pres që të më drejtoheni qoftë me kërkesë për seancë  
11 *ex parte* apo parashtrime *ex parte*.

12 A kanë palët diçka tjetër për të shtuar për sot?

13 Z. Prokuror.

14 Z. O'DOWD: [Përkthim] Asgjë nga ne.

15 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Prokuror.

16 Mbrojtja.

17 Z. GILISSEN: [Përkthim] S'kemi asgjë për të shtuar z.

18 Kryetar. Faleminderit shumë.

19 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Ju faleminderit.

20 Me kaq përfundojmë seancën e sotme. Falënderoj palët dhe  
21 Përfaqësuesin e Zyrës Administrative për praninë e tyre.

22 Falënderoj përkthyesit, stafin teknik, stenografet, edhe  
23 personelin e sigurisë për ndihmën e tyre.

24 Me kaq përfundon seanca e sotme.

25 --- Konferenca mbi ecurinë e çështjes mbyllet në

1 orën 10.04.

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25